



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.5.2023

Nr: 71

Ora: 01:00

U R D H Ë R

P Ë R

**VAZHDIMIN NË MËNYRË TË PANDËRPRERË TË PROCESIT TË NUMËRIMIT PËR ZGJEDHJET PËR  
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të pikës 1, shkronja “b”, dhe pikës 2, të nenit 19, e neneve 32, pika 1, shkronja a dhe pika 3, 33 shkronja a dhe ë, neni 119 pika 5, neni 168 dhe 171 pika 5, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 23, datë 24.4.2023 “Për organizimin e punës në Vendin e Numërimit të Votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

**URDHËROJ:**

1. KZAZ-të të zhvillojnë procesin e numërimit të votave për kandidatët për kryetar të bashkisë dhe të këshillit bashkiak në mënyrë të pandërprerë.
2. KZAZ të marrin masa për zëvendësimin në kohë të anëtarëve të grupeve të numërimit nëse është rasti.
3. KZAZ-të të plotësojnë dhe të administrojnë në mënyrë të saktë tabelat e rezultatit dhe çdo dokument tjetër zgjedhor, si dhe t'i përcjellin ato në KQZ nëpërmjet sistemit përkatës të transmetimit të të dhënave.
4. KZAZ-të sigurojnë kushtet që çdo votë që numërohet dhe vlerësohet, të vëzhgohet nëpërmjet teknologjisë mbështetëse.
5. Ngarkohen KZAZ-të për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**